

# Credins Bank, Hazizaj: Kërkesa më të mëdha nga fasoneria dhe tregtia

**A**nila Hazizaj, Drejtore e Departamentit të Riskut në Credins Bank tha se, nga kërkesat që kanë ardhur, peshën më të lartë në numër e zënë SME-të, ndërsa në vlerë, Biznesi i madh (korporatat); nga sektorët kryesorë, tregtia, fasoneritë dhe tregtimi i hidrokarbureve

**A kanë nisur aplikimet për alokimin e fondeve që vuri në dispozicion qeveria si garanci sovrane për të kredituar bizneset në vështirësi? Nëse po, si po shkon ky proces?**

Pas nënshkrimit të marrëveshjes me MFE për garancinë sovranë, javën e kaluar, Banka Credins ka filluar menjëherë punën për përcaktimin e termave, kushteve, si dhe ngritjen e së gjithë infrastrukturës së nevojshme për fillimin e financimit të klientëve të saj me kapital qarkullues, të destinuar për pagesën e pagave të punonjësve për periudhën mars-maj 2020. Termat specifikë të kësaj marrëveshje e kanë bërë të domosdoshme përpilimin e një procedure të posaçme për kreditimin e klientëve me garancinë e qeverisë, modifikimin e formularëve të aplikimit, kontratatave të kredive dhe një sërë dokumentacioni të nevojshëm për procesin kreditues. Duke qenë se dhe Banka Credins, si çdo institucion tjetër në vend, u nënshtrohet orareve kufizuese të vendosura nga shteti dhe në kushtet kur po punohet me staf të reduktuar, finalizimi i skedës së



këtij produkti specifik, në një kohë sa më të shkurtër, paraqet vështirësitë e veta. Megjithatë, jemi në fazën finale të këtij procesi dhe parashikojmë që javën e ardhshme të nisim me kreditimin e shoqërive. Ndërkohë jemi duke pranuar aplikimet e klientëve që janë të interesuar për kredinë sovranë, po analizojmë kërkesat e tyre dhe sapo të zbardhet skeda e produktit, do të fillohet dhe me lëvrimin e fondeve në logaritë e shoqërive kredimarrëse.

**Çfarë kushtesh specifike keni venë për klientët tuaj që të përfitojnë nga kjo garanci, përveç atyre të përcaktuara nga Vendimi i qeverisë nr. 277, datë 6/4/2020?**

Kushtet të cilat do të aplikohen nga banka janë kryesisht ato të përcaktuara në marrëveshjen e firmosur ndërmjet Bankës Credins dhe MFE. Megjithatë, vlen të theksohet fakti se, nga ana e bankës, po krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme si në drejtim të dokumentacionit të reduktuar që duhet të paraqitet nga aplikuesit, ashtu dhe në drejtim të lehtësimit të kostove që do të aplikohen

për këto kredi. Padyshim që klientët të cilët aplikojnë për kredinë sovranë, duhet t'i kalojnë pagat e punonjësve pranë bankës sonë.

**Sa për qind të garancisë keni alokuar deri më tani dhe a është e mjaftueshme për të plotësuar të gjitha nevojat që kanë klientët tuaj?**

Mbështetur në kërkesat që janë paraqitur deri në këtë moment në Bankë, mendojmë se vlera prej 2 miliardë lekë, alokuar nga qeveria si fond garancie, është e mjaftueshme.

**Cilët sektorë kanë aplikuar më së shumti dhe ku ka qenë e përqendruar kërkesa, te bizneset e vogla apo ato të mëdha?**

Nga kërkesat që kanë ardhur, peshën më të lartë në numër e zë Biznesi SME ndërsa në vlerë, Biznesi i madh (korporatat). Ndër sektorët kryesorë do të veçoja atë të tregtisë, fasoneritë dhe tregtimit të hidrokarbureve.

**A është duke përdorur banka juaj instrumente të tjera të lehtësuese kreditimi për të mbështetur klientët për përbalimin e situatës?**

Situata e krijuar për shkak të masave shtrënguese të marra nga Qeveria, në kuadër të parandalimit të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 patjetër që ka dhënë ndikim negativ në situatën financiare të bizneseve dhe individëve. Një ndër masat e marra nga Credins, për t'ju ardhur në ndihmë klientëve kredimarrës, ka qenë shtyrja e kësteve të kredive për periudhën mars-maj 2020. Përveç kësaj mase, që prej muajit mars, për të gjithë portofolin e kredisë, janë zëruar penaltitetet për pagesat e kësteve në vonesë. Ndërkohë banka po trajton me përparësi kërkesat për kreditim të klientëve kredimarrës të cilëve, nuk ju është pezulluar aktiviteti, por për shkak të kufizimeve në lëvizjen e lirë të njerëzve, ju është ulur ndjeshëm niveli i të ardhurave. Ky grup klientësh po ndihmohet me kapital qarkullues, për të kryer në kohë pagesat ndaj palëve të treta, rritje inventari me qëllim përmbushjen në kohë të kërkesave të klientëve, etj. ■

